



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-PR-2020-09

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 maj 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese
të Dhomave të Specializuara**

Gjykatësve të panelit të Gjykatës Kushtetuese:

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Antonio Balsamo

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 19(5) dhe 32(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullës 7(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) dhe rregullës 4(2) të Rregullores së Caktimit të Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja e Caktimit të Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi, cakton panelin e Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara (“paneli”) për shqyrtimin e ndryshimeve të miratuara të Rregullores.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 dhe 30 prill 2020, gjatë mbledhjes së tyre plenare, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës miratuan ndryshime të 30 rregullave në pajtim me nenin 19(4) të Ligjit dhe rregullën 7(5) të Rregullores.¹

2. Më 1 maj 2020, Kryetarja i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ndryshimet e miratuara të Rregullores, për të garantuar përputhjen e tyre me Kapitullin II, ndër të tjera me nenin 55, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.²

II. CAKTIMI

3. Në bazë të nenit 33(3) të Ligjit, caktohen gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Në përputhje me rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, Kryetarja është siguruar se të tre gjykatësit janë në dispozicion për caktimin.

¹ Në përputhje me nenin 19(1) të Ligjit dhe rregullës 7(2) të Rregullores, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese nuk morën pjesë në miratimin e ndryshimeve të Rregullores.

² F00001, Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, 1 maj 2020 (me shtojcë konfidenciale).

